

PHOSTOXIN TABLETS

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE

“Klasa: 1a”, T+



“SHUME HELMUES”. “N- I DEMSHEM PER MJEDISIN”

“SHUME HELMUES ME FRYMEMARRJE DHE NESE GELLTITET”. “LEHTESISHT I NDEZSHEM”.

Perdoret ne perputhje me rregullat per trajtimet me fosfid hidrogjeni, nga persona te pajisur me deshmi aftesie te veçante. Te shmanget kontakti me ujin.

PHOSTOXIN TABLETS permban fosfid alumini dhe, ne kontakt me lageshtine e ajrit çliron fosfid hidrogjeni (fosfine). Perdoret si insekticid/rodenticid per kontrollin e demtueseve te depove.

Lenda vepruese: Fosfid alumini 56%

Formulimi: Tableta (Çdo tablete peshon 3 gr dhe çliron 1 gr fosfid hidrogjeni).

Masat parambrojtese:

- Te ruhet larg femijeve, ne ambalazhin origjinal, ne nje dhome te mbyllur, larg banesave, lageshtise, zjarrit dhe nxehtesise.
- Ruajeni larg ushqimeve dhe pijeve te njerezve si dhe ushqimeve te kafsheve.
- Mos hapni ambalazhin deri ne çastin e perdorimit.
- Mos e perdorni ne ndertesa te banuara.
- Gjate punes te perdoret maske me filter gazi, e pershtatshme per fosfidin e hidrogjenit.
- Gjate punes mos hani dhe mos pini lengje e duhan.
- Gazi i çliruar te mos frymemerret.

Udhezime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun:

- Ne rastet kur nuk mbahen parasysh udhezimet per perdorimin ose per pakujdesi te tjera, pamvaresisht nga sasia e fosfines se marre me frymemarrje, mund te shfaqen simptoma si lodhje, zhurme te vesheve, perzierje, vjellje, diarre, dhimbje gjoksi, çrregullime te ekuilibrit.
- I demtuari duhet te nderprese menjehere punen, te largohet nga zona e rrezikshme dhe ti hiqen rrobat e ndotura dhe qe e shtrengojne.
- Nese ndjeni shqetesime, kerkoni menjehere ndihme mjekesore dhe i tregoni mjekut etiketen.
- Ne helmimet e lehta, i demtuari te qendroje ne qetesi, ne ajer te paster e te ngrohte dhe simptomat largohen plotesisht pa pasoja. I demtuari nuk duhet te vazhdoje punen ate dite edhe nese ndjehet mire.
- Ne helmimet e renda ose nese simptomat pas pak kohe nuk largohen te demtuarit t'i jepet menjehere ndihme mjekesore.
- Rekomandohen tonike te zemres ose ilaçe qe stimulojne qarkullimin e gjakut, ne rast te edemes pulmonare toksike duhet te jepen doza maksimale glucocorticoides.
- Nuk ka antidot specifik. Mjekimi simptomatik.

Perdorimi:

Perdoret per kontrollin e demtuesve ne drithra, gjethet e duhanit, ushqimet e perpunuara dhe ushqimet e kafsheve. Te gjithë artikujt ne ruajtje fumigohen nen nje mushama gazmbrojtese ose nen nje mbulese tjeter te mbyllur. Kontrollon kalandrat, miellngrenesin e surinames, gerryesin e farerave, molen e drithrave, fluturen e hambareve dhe te mullinjve, brumbullin e duhanit, etj.

Fusha e perdorimit	Doza e rekomanduar
--------------------	--------------------

Grumbuj te lire drithi	2-6 tableta/ton
Prodhime ne hambare e sillose	2-5 tableta/ton
Prodhime ne thase te stivosur	1-3 tableta/m ³
Gjethe duhani ne dengje, arka, dhoma, etj	0.5-1 tablete/m ³
Ne ambientet e paketimit te ushqimeve dhe ushqimeve te kafsheve	1-3 tableta/m ³
Ne dhoma dhe ambiente te tjera gazifikimi	1-3 tableta/m ³

Gjate trajtimit duhet te mbahen parasysh temperaturat e mjedisit per kohen e nevojshme per trajtim:

- 4 dite ne temperature 15-20 ° C; - 7 dite ne temperature 10-15 ° C; - 14 dite ne temperature 5-10 ° C.

Ne te gjitha rastet prodhimi ose produkti duhet te mbulohet me nje mbulesë te papershkueshme nga gazi dhe te izolohet mire.

Udhezime per perdorimin:

Mund te perdoret vetem nga persona te autorizuar.

Objektet e trajtuara duhet te dallohen me tabela te shkruara qarte e dukshem dhe vetem ne aksidente te futet me maska mbrojtese per frymemarrjen.

Per hapjen e dritareve per ajrim, duhet te futen 2 persona te paisur me maska me filter gazi.

Dhomat qe kufizohen me objektet e trajtuara duhet te ajrosen vazhdimisht. Ne to mund te punohet, por ne asnje rast nuk duhet fjetur. Perdoruesit e dhomave kufizuese duhet te njoftohen per rrezikun e trajtimit me kete preparat. Objektet e trajtuara dhe dhomat kufizuese jane te perdorshme pas ajrimit te tyre, n.q.s. prova e bere per mbetjen e gazit eshte negative.

Pjeset e vjetra te ambalazhit dhe mbeturinat nuk duhet te grumbullohen ne mbeturinat e shtepise, por te trajtohen sipas rregullave ne fuqi.

Ne rast zjarri perdorni shkume, puder speciale fikse ose CO₂. Nuk duhet perdorur uje.

Magazinimi:

Preparati ruhet ne vende te ajrosura, pa lageshti, ne temp. 0-35⁰ C, larg qendrave te banimit. Magazina te jete detyrimit e pajisur me mjetet kunder zjarrit, te jete e sigurte nga rryma elektrike.

Nr dhe data e regjistrimit: 83/2; date 23.7.2012

Sasia neto e PMB-se, qe ndodhet ne ambalazhin baze: deri 1 kg.

Data e prodhimit

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kerkeseve te percaktuara): 5 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese

Tipi i ambalazhit baze: Sipas paketimit origjinal.

Emri dhe adresa e Aplikantit: Detia Degesch GmbH. **Adresa:** Laudenbach, Germany.

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Detia Degesch GmbH. **Adresa:** Laudenbach, Germany.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhi kryhet ne Republiken e Shqiperise):